



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Korçë

VITI 2019

Tabela e Përmbajtjes

MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	3
GJETJET KRYESORE	3
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË KORÇË	5
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2019	6
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	6
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	9
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN ETYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.	13
REKOMANDIME.....	13

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019.

Gjetjet kryesore

- Bashkia e Korçës është një prej bashkive e cila ka patur një ekip të konsoliduar prej 9 vitesh ku edhe bashkëpunimi ndërinstitucional sipas raportimit ka pasur nivele të kënaqshme.
- Pengesë duke nisur nga Marsi 2019 ka qënë mungesa e një koordinatori vendor kundër dhunës në familje për koordinimin e punës midis anëtarëve të MKR-së, për shkak të largimit të tij nga ky pozicion. Në mesin e muajit tetor bashkia ka përcaktuar znj. Inelda Hasankolli e cila është trajnuar nga bashkia edhe nga Aleanca Gjinore për Zhvillim për të përmbushur detyrën e re të ngarkuar.
- Komisariati i Korçës ka evidentuar 149 raste të dhunës në familje, nga të cilat 117 janë gra/vajza.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka akorduar 68 Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm Mbrojtje
- Bashkia Korçë ka krijuar një plani veprimi për barazinë gjinore në nivel lokal, i cili gjatë 2019 ka nisur të zbatohet sipas aktiviteteve të parashikuara, për të ndikuar kështu në jetën sociale dhe në sensibilizimin qytetar për rëndësinë e elementëve të barazisë gjinore.
- Mungesa e Koordinatorit vendor ka bërë që mos ketë mbledhje të mirëfillta të MKR-së, megjithatë duke qenë se ekipit teknik ndërsektorial përbëhet nga aktorë edhe të ekipit multidisiplinar të Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve (GTN), janë trajtuar raste specifike lidhur me dhunë në familje të fëmijëve, duke trajtuar kështu edhe familjen me probleme dhune në familje duke dhënë zgjidhje për rastin.
- Përgjatë vitit 2019, GTN pranë kësaj bashkie u mbledh 6 herë ndërkohë që Komiteti Drejtues nuk ka organizuar asnjë mbledhje.
- Strehëza emergjente pranë kësaj bashkie për vitin 2019 ka strehuar viktimat e 5 rasteve të dhunës në familje. Problem është vetëm kati, në të cilin ndodhet ky apartament, kati i gjashtë është i papërshtatshëm dhe pa ashensor.
- Bashkia Korçë ka vënë në dispozicion në vitin 2019 dy projekte të financuara nga buxheti i saj, për të asistuar rastet e dhunës në familje dhe për sensibilizimin qytetar ndaj fenomenit. Këto dy projekte janë: “Strehëza emergjente për viktimat e dhunës në familje” dhe

“Ndërgjegjësimi i komunitetit rural nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje”. Buxheti i vënë në dispozicion për këto dy projekte është 503.000 lekë gjithsej.

- Tre prej organizatave kryesore që veprojnë në fushën e dhunës me bazë gjinore në bashkinë e Korçës dhe që shpesh plotësojnë shërbimet që bashkia nuk ka mundësi të ofrojë janë organizata fetare, specifikiisht Misioni Emanuel, Fondacioni Kenedi dhe Jezu Krishti për Ballkanin. Këto organizata plotësojnë shërbimet për viktimat e dhunës në familje me ndihma të drejtpërdrejta me veshmbathje dhe ushqime.
- Hedhja e të dhënave në sistemin online REVALB pas muajve të parë të vitit 2019 nuk është kryer në mënyrë të rregullt, si pasojë e mungesës së koordinatores së larguar në muajin mars '19. Të gjitha rastet janë plotësuar online gjatë muajit dhjetor nga koordinaroja e re pranë kësaj bashkie.
- Bashkia Korçë vazhdon të ketë funksional numrin pa pagesë 0800 3434 për denoncimin e rasteve të dhunës në familje, por që jep shërbim 5 ditë të javës gjatë orarit zyrtar. Përgjegjës për këtë shërbim është koordinatori vendor që kryhen njëkohësisht dhe detyrat e tjera parashikuar në ligj. Është fakt prej disa vitesh, pavarësisht promovimit të herë pas hershëm të numrit pa pagesë, si shërbim shtesë ndaj qytetarit, ata preferojnë të denoncojnë rastet në komisariat dhe tek zyra kundër dhunës në familje.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Korçë

Të dhënat statistikore nga Gjykata e rrethit Korçë¹

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë janë akorduar në total 68 UMM/UM përgjatë vitit 2019. Rezulton se grup-mosha më e prekur nga dhuna është 40-50 vjeç, marrëdhënia më problematike është ajo e lidhjeve familjare 45.5% e rasteve. Dhuna më së shumti e ushtruar është ajo psikologjike. Gjatë 2019, ka pasur 4 raste të miturish viktime të dhunës në familje, të pajisur me UM. Ndërkohë që vetëm 36% të rasteve kanë përfituar urdhër mbrojtje, për shkak të tërheqjes së kërkesë padisë ose “pajtimit” mes palëve.

Të dhëna statistikore nga Drejtoria e Policisë Korçë²

Përgjatë vitit 2019, janë evidentuar 149 raste të dhunës në familje, nga të cilat 117 viktimat ishin gra/vajza. Ndërkohë që numri i rasteve të veprës penale “dhunë në familje” neni 130/a për vitin 2019 ishte 29 dhe u arrestuan 19 autorë.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, sipas Ligjit 9669, datë 18.12.2006, janë plotësuar 107 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje dhe kanë rezultuar 8 raste të shkeljes së urdhrit të mbrojtjes.

Të dhënat për bashkinë Korçë janë përpunuar nga statistikat e komisariatit qendër në këtë rreth. Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar.

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Korçë.

Përshkrimi	Komisariati Korçë
Evidentuar	149
Të dëmtuar gjithsej	152
Prej tyre gra/vajza	117
Kërkesë për U.Mbrojtje	107
Shkelje e U.Mbrojtjes	8
V. P. Neni 130/a	29
Arrest. për 130/a	19
Ndaluar për 130/a	0
Gjendje të Lirë për 130/a	11
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

¹ Burimi: Koordinatorja Vendore pranë Bashkisë Korçë

² Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të dhënat statistikore nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë³

Sipas informacioneve zyrtare të përfituara, prokuroria e këtij rrethi, për bashkinë e Korçës për periudhën 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019 ka regjistruar vetëm 4 procedime për dhunën në familje sipas nenit 130/a/1,2,3,4, nga të cilët me 2 persona nën hetim.

Të dhënat statistikore nga MKR Korçë⁴

Gjatë periudhës 12 mujore për vitin 2019 Mekanizmi Kombëtar i Referimit pranë bashkisë Korçë ka trajtuar 132 raste, nga të cilat 103 femra dhe 29 meshkuj.

Ndër rastet e mësipërme ka patur 9 raste të referuara nga mini-ekipet teknike të Njësisë Administrative të trajtuara në mbledhjet e MKR-së. Ndërkohë që nga zonat rurale janë regjistruar 35 raste të dhunës në familje të denoncuara në Komisarjatin e Korçës pranë kësaj bashkie.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia e Korçës ka një ekip të konsoliduar tashmë prej 9 vitesh. Bashkëpunimi ndërinstitucional edhe gjatë vitit 2019 ka qënë në përgjithësi kënaqshëm

Pengesë duke nisur nga Marsi 2019 ka qënë mungesa e një koordinatorës vendore kundër dhunës në familje për koordinimin e punës midis anëtarëve të MKR-së, për shkak të largimit të saj nga ky pozicion, por përgjatë muajve të kësaj mungese (mars – tetor), ky koordinim është kryer nga Drejtoria e Shërbimit Social pranë kësaj bashkie.

Në përputhje me objektivin 3.1 për rritjen e ndërgjegjësimin në komunitet rreth rëndësisë së luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje Bashkia e Korçës ka një projekt specifik për ndërgjegjësimin e popullatës në qytet dhe në zonat rurale, një projekt i cili është miratuar edhe gjatë 2019 nga Këshilli Bashkiak.

Bashkia Korçë ka realizuar fushata sensibilizuese në qytet dhe në zonat rurale. Në kuadër të këtyre fushatave janë vendosur dhe shpërndarë fletëpalosje në të gjitha rajonet administrative me qëllim

³ Burimi: Koordinatorja Vendore pranë Bashkisë Korçë

⁴ Burimi: Koordinatorja Vendore pranë Bashkisë Korçë

që informacioni të shkojë në të gjithë territorin e Bashkisë. Gjithashtu janë organizuar takime informuese me anëtarë të komunitetit për çështjet gjinore dhe të drejtën pronësore.

Zyra Kundër Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore, Bashkia Korçë ka organizuar në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore dhe Sherbimin Social aktivitete me shkollat 9-vjeçare në zonat rurale dhe qytet. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë nxënës, prindër, mësues. Ata janë informuar mbi çështjet që lidhen me dhunën në familje, çështjet e diskriminimit, dhunën me bazë gjinore, si dhe konceptet e barazisë gjinore.

Gjatë muajit dhjetor janë organizuar aktivitete sensibilizuese në qytet në kuadër të “16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave”. Aktiviteti mbylles u zhvillua në bashkëpunim Komisionerin kundër Diskriminimit Korçë.

Zyra kundër dhunës në familje dhe barazisë gjinore është aktive jo vetëm gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, por gjatë gjithë vitit, për të sensibilizuar opinionin publik. Informacioni është përcjellë edhe nëpërmjet kronikave të lajmeve për sa i përket trajtimit të rasteve dhe shërbime e ofruara nga MKR Bashkia Korçë.

Bashkia Korçë ka ndërmarrë një tjetër hap të rëndësishëm për të çuar më tej përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri, përmes miratimit nga Këshilli Bashkiak të “Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore për Korçën”, pas nënshkrimit të “Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore” nxitur dhe mbështetur nga UN Women.

Po në këtë kuadër Bashkia Korçë ka një numër pa pagesë 0800 3434 për denoncimin e rasteve të dhunës në familje, por që jep shërbim 5 ditë të javës gjatë orarit zyrtar. Përgjegjës për këtë shërbim është koordinatoreja vendore KDHF, që kryen njëkohësisht dhe detyrat e tjera parashikuar në ligj. Është fakt prej disa vitesh, pavarësisht promovimit të herë pas herës të numrit pa pagesë, si shërbim shtesë ndaj viktimave të dhunës në familje, ata/ato preferojnë të denoncojnë në 99% të rasteve në komisariat dhe tek zyra kundër dhunës në familje drejtpërsëdrejti ose komunikojnë nëpërmjet numrit 129.

Bashkia Korçë në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm të këtij qarku kanë organizuar pesë aktivitete sensibilizuese për vitin 2019. Ky bashkëpunim është koordinuar me:

- Dorkas/Emanuel;
- Gruaja në Zhvillim Korçë;
- Drejtoria e Policisë;
- Drejtoria e Arsimit (shërbimi psiko-social);
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Zyra e Punës dhe Shëndeti Publik.

Në lidhje me aktivitetet sensibilizuese, janë përfshirë rreth 300 nxënës në ambjentet e shkollave, ndërsa me dhjetra të tjerë janë informuar nëpërmjet materialeve promovionale, të cilat janë shpërndarë në shkollë nga mësuesit kujdestarë.

Rreth 100 qytetarë kanë marrë pjesë në aktivitete informuese më tema të caktuara në ambjente të mbyllura dhe me dhjetra qytetarë janë informuar nëpërmjet emisioneve televizive dhe radiofonike në televizionet lokale. Gjithashtu dhjetra qytetarë kanë marrë informacion gjatë aktiviteteve sensibilizuese në zona të caktuara të qytetit.

Fokus ishin target grupet e nxënësve të shkollave të mesme; të rinj e të reja të qendrës Rinore Korçë; qytetarë; gra dhe burra anëtarë të komuniteteve në nevojë dhe pakicave kombëtare.

Në total tre aktivitete të koordinuara janë realizuar gjatë këtij viti nga organizatat e shoqërisë civile dhe Bashkisë:

- Dy aktivitete me temë mbi barazinë gjinore janë realizuar nga Misioni Emanuel e Dorkas me prindërit e qendrës multifunktionale.
- Një mbledhje e vecantë e Bordi Këshillimor qytetar është organizuar për problematikat lidhur me barazinë gjinore dhe rolin e gruas në vendimmarrje.

OSHC-të që operojnë dhe bashkëpunojnë me Bashkinë Korçë:

1. Gruaja në Zhvillim Korçë.
2. Misioni Emanuel dhe Dorkas.
3. Agjencia Rajonale e Zhvillimit nëpërmjet Bordit Këshillimor Qytetar.

Tabela 2. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	26 Nentor	Qendra rinore	Çelja e fushatës kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave	Bashkia Korçë
2	3 Dhjetor	Qendra rinore	Ndërgjegjësimi dhe informimi i të rinjve mbi dhunën në familje	Bashkia Korçë
3	6 Dhjetor	Qendra rinore	Ndërgjegjësimi dhe informimi i të rinjve mbi dhunën në familje	Bashkia Korçë

4	10 Dhjetor	Qendra rinore	Ndërgjegjësimi dhe informimi i të rinjve mbi dhunën në familje	Bashkia Korçë
---	------------	---------------	--	---------------

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Edhe për vitin 2019, ashtu siç edhe në 2018-ën, funksionimi i mekanizmit të referimit rezulton të jetë disi i mirë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore nga ana e bashkisë së Korçës. Në bazë të të dhënave të mbledhura nga bashkia dhe rezultatet e monitorimit të punës së bashkisë, rezulton se bashkia Korçë ka kapacitetet e duhura për të përdorur mekanizmin e referimit dhe ofrimin e eksperiencave të saj.

Grupi Teknik Ndërdisciplinar pranë këtij mekanizmi përgjatë vitit 2019 ka organizuar 6 mbledhje të zakonshme, konkretisht në datë 7 janar, 28 mars, 3 korrik, 1 nëntor 2019, 13 dhjetor 2019 dhe në 30 dhjetor. Prezent kanë qënë të gjitha institucionet anëtare të mekanizmit të referimit përveç Zyrës së Përmbartimit dhe Gjykatës.

Ndërkohë që Komiteti Drejtues pranë bashkisë Korçë nuk është mbledhur asnjë herë përgjatë vitit kalendarik 2019.

Ndërkohë që koordinatoresha vendore shpërndan me anëtarët e MKR-së raportet e mbledhjeve peridoke si dhe ato të rasteve emergjente. Ndërsa në lidhje me shkëmbimin e informacionit me Drejtorinë e Policisë ky raportim bëhet çdo muaj.

Sistemi i hedhjes të të dhënave “Revalb” në lidhje me statistikat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk ka probleme në përdorimin apo plotësimin e tij. Duke qënë se Koordinatorja e mëparshme u largua në muajin marës, rastet e ndjekura përgjatë vitit deri në muajin tetor në caktimin e koordinatoreshes së re, janë hedhur dhe përditësuar të gjitha deri në fund të muajit dhjetor.

Koordinatorja vendore kundër dhunës me bazë gjinore për Bashkinë Korçë është znj. Inelda Hasankolli që prej datës 16 tetor 2019, pasi kordinatorja e mëparshme dha dorëheqjen. Sidoqoftë, në kontratën e nënshkruar me bashkinë znj. Hasankolli mban pozicionin e Specialistes kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Paga e saj është pjesë e buxhetit të bashkisë përsa i përket mekanizmit të referimit dhe është 44.897 lekë/muaj (bruto).

Sipas të dhënave të përftuara nga bashkia ky pozicion nuk ka role të tjera në bashki, duke lejuar kështu përqendrim të plotë tek lufta kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Znj. Hasankolli, si punonjëse e re në këtë detyrë ka marrë pjesë në disa trajnime mbi dhunën në familje dhe çështjet gjinore, duke përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës seksuale, specifikisht:

- “Dhuna ndaj gruas dhe dhuna seksuale“ nga Znj Rebecca Vagi nga UK (29 tetor 2019) organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim.
- “Ndërtimi i kapaciteteve të OSHC për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016/2020.“ (nëntor 2019) organizuar nga Ministria e Shëndetit dhe Punës Sociale.
- “Dhuna në familje dhe roli i autoriteteve përgjegjëse.“ (nëntor 2019) organizuar nga UNDP

Bashkia Korçë edhe për vitin 2019 ka zbatuar dy projekte të financuara nga buxheti i saj, për të asistuar rastet e dhunës në familje dhe për sensibilizimin qytetar ndaj fenomenit.

1. “Strehëza emergjente për viktimat e dhunës në familje” dhe
2. “Ndërgjegjësimi i komunitetit rural nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje”.

Buxheti i vënë në dispozicion (2019) për këto dy projekte është 424.900 lekë gjithsej.

Pranë strehëzës emergjente përgjatë vitit 2019 janë strehuar 5 përfitues gjithsej: 1 grua; një burrë dhe tre fëmijë të shoqëruar nga nëna e tyre.

Problem është vetëm kati, në të cilin ndodhet ky apartament, kati i gjashtë është i papërshtatshëm dhe pa ashensor. Megjithatë nga ana e Bashkisë Korçë dhe fondacionit partner janë marrë të gjitha masat e sigurisë, që mos ndodhin incidente si pasojë e ngarkesën psikologjike që mund të ketë viktimat e dhunës në familje. Është e rëndësishme që shërbimi psikosocial në strehëz të behët nga një psikolog i specializuar për dhunën në familje.

Ndërkohë që rastet e referuara nga mekanizmi I referimit pranë Zyrës së Punës në bashkinë Korçë përgjatë vitit 2019 ishin 11 në total. Por, mbetet problematikë punësimi I tyre. Gratë/vajzat viktimat e dhunës në familje, në të shumtën e rasteve nuk e pranojnë punën e ofruar ndërsa në rastet kur e pranojnë këtë punë, largohen brenda javës së parë të punësimit.

Megjithëse bashkëpunimi për rastet e dhunës në familje i Bashkisë Korçë me policinë paraqitet si shumë i mirë për vitin 2019, nuk ka dokumenta që e vërtetojnë këtë bashkëpunim, duke qenë se ky është i përditshëm dhe kryhet në bazë të marrëveshjes mes dy institucioneve.

Gjithashtu, edhe në rastin e bashkëpunimit me Zyrën e Punës, nuk ka dokumenta mbështetëse që vërtetojnë bashkëpunimin mes dy institucioneve. Ndiqet procedura nga bashkia, institucion ky që referon rastet e punësimit dhe më pas zyra e punës e ndjek këtë procedurë për mundësinë e punësimit të referuar nga bashkia.

Me drejtorinë Arsimore bashkëpunohet në rast të aktiviteteve sensibilizuese me shkollat, ndërkohë që me shërbimin psiko-social bashkëpunon NJMF në rast se i referohet ndonjë problematikë nga ky shërbim ose nga stafi pedagogjik.

Duke qenë se edhe Shërbimi Social është pjesë e MKR, sa herë ka pasur nevojë për sistemim të viktimave të dhunës në Strehëzën Kombëtare, ky institucion është përfshirë. Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur raste që kanë janë referuar nga ky mekanizëm për në Strehëzën Kombëtare në Kamëz.

Në përgjithësi Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Menjherëshëm të Mbrojtjes plotësohen nga efektivet e policisë së bashkisë Korçë.

Tabela 3. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2019 në Bashkinë Korçë

Data	Vendi	Temat
7.1.2019	Bashkia Korçë	Prezantimi i gjetjeve lidhur me situatën sa i takon nevojës për shërbime për viktimat e dhunës në familje.
28.3.2019	Bashkia Korçë	Trajtimi I rasteve të referuara pranë Bashkisë Korçë
3.4.2019	Bashkia Korçë	Trajtimi I rasteve të referuara pranë Bashkisë Korçë
1.11.2019	Bashkia Korçë	Takim I anëtarëve të mekanizmit me Koordinatorin e re të bashkisë Korçë
13.12.2019	Bashkia Korçë	Trajtim I rasteve të referuara
30.12.2019	Bashkia Korçë	Analizë e punës së Mekanizmit të referimit dhe anëtarëve specifikë.

Burimi: Bashkia Korçë

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Korçë

Viti	Mbledhjet e KD
2019	Nuk është organizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues përgjatë vitit 2019.

Burimi: Bashkia Korçë

Tabela 5. Lista emërore e Komitetit Drejtues pranë bashkisë Korçë

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia Korçë	Sotiraq Filo
Drejtoria e Policisë	Lorenc Panganika
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Juljeta Kole
Prokuroria e Rrethit	Dhorina Theodhori
Drejtoria Arsimore Rajonale	Kristaq Grabocka
Drejtoria e Shëndetit Publik	Mikel Llogori
Zyra e Përmbartimit	Olta Shkëmbi
Drejtoria e Shërbimit Social shtetëror	Mariana Lorgji
Fondacioni Jezus krishti për Ballkanin	Lorenc Ahmet
Fondacioni Kenedi	Ian Loring

Tabela 6. GTN-ja e Bashkisë Korçë viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Illir Zguri Drejtor I Kujdesit Social Elizeta Bita Specialiste KDHFdhe BGj (deri në mars 2019) Inelda Hasankolli Specialiste KDHFdhe BGj (nga nëntor 2019 – në vijim)
Drejtoria e Policisë	Dhurata Ahmeti specialiste
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Esmerald Xhafa kancelar
Prokuroria e Rrethit	Ollga Visi
Drejtoria Arsimore Rajonale	Anila Bitraku
Drejtoria e Shëndetit Publik	Elisabeta Dino
Zyra e Përmbartimit	Olta Shkëmbi (Kryetare)
Prefektura	
Kryetarët e Njësive Administrative	Agim Bace, Ylli Ndini, Irena Gambeta
Zyra e Punësimit	Helena Zhappa
Organizata Jo qeveritare	Daniela Ahmet
Strehëzat për viktimat e dhunës	Erion Jonuzllari
Komunitete fetare	Nuk ka
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk ka

Burimi: Bashkia Korçë

Përgjatë vitit 2019 nuk janë plotësuar Kërkesë Padi nga Bashkia Korçë. Këto Kërkesë Padi janë referuar në komisariat. Përgjithësisht këto kërkesë padi, plotësohen nga inspektorët e lagjeve në komisariat.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë janë akorduar në total 68 UMM/UM përgjatë vitit 2019. Rezulton se grup-mosha më e prekur nga dhuna është 40-50 vjeç, marrëdhënia më problematike është ajo e lidhjeve familjare 45.5% e rasteve.

Ndërkohë që nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit raportohet që për vitin 2019 për bashkinë Korçë është egzekutuar vetëm një rast me objekt “Urdhër Mbrojtje”, ndërkohë që 17 kanë qenë rastet e egzekutuara me objekt “takim fëmije” dhe 364 raste për “pension ushqimor”.

Edhe për vitin 2019, situata vijon të jetë e njëjtë, duke qenë se në Korçë nuk ka qendra rehabilituese, as qendra ku të jepet shërbim psikologjik apo terapi grupi, apo për rehabilitim e personave që janë përdorues të lëndëve narkotike dhe alkoolit. Dhunuesit që janë përdorues të lëndëve narkotike janë shumë problematikë dhe pjesa më e madhe e tyre janë të rinj, të cilët përveç shkaktimit të problemeve ekonomike janë ushtrues të dhunës psikologjike dhe fizike tek prindërit dhe të afërmit e tyre.

Njësoj si në vitin 2018, edhe për 2019-ën, shërbimi i provës megjithë publikimin e statistikave në rang kombëtar dhe rajonal, nuk i ndan ato sipas llojit të veprës penale, gjinisë si edhe llojit të dënimit alternativ të kryer. Kjo e pengon krijimin e një panorame të saktë për dënimet alternative dhe përpjekjet rehabilituese të autorëve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Aktualisht shërbimi i provës në bashkinë e Korçës vijon të ketë mangësi.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Korçës për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Korçë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Rekomandojmë që GTN-ja e kësaj bashkie duhet të mbledhet në mënyrë të rregullt.
- Të gjithë anëtarët e këtij mekanizmi duhet të jenë prezent në mbledhjet e organizuara.

- Rekomandohet që Komiteti Drejtues pranë kësaj bashkie të mbledhet sa më shpejt, sidomos me problematikat që ky mekanizëm ka shfaqur gjatë vitit 2019.
- Në territorin e Bashkisë Korçë nuk ka asnjë organizatë apo qendër që të mundësojë programe këshillimi për djemtë dhe burrat ose të mundësojë trajtimin dhe rehabilitimin e dhunuesve. Ka pasur raste të menaxhuara që nuk janë raste suksesi, sepse në Korçë nuk ka qendra rehabilituese për personat me varësi nga drogërave dhe alkoolit, ndaj ngritje e një qendre të tillë është një nga rekomandimet tona më të forta për këtë bashki.
- Rekomandojmë trajnime të përbashkëta ku të marrin pjesë të gjithë anëtarët e mekanizmit në mënyrë që zbatueshmëria e ligjit të jetë sa më efektive dhe informacioni të jetë i plotë edhe për ata anëtarë që janë zëvendësuar ndër vite brenda mekanizmit të referimit. Ndryshimi i herë pas hershëm i përfaqësuesve të institucioneve publike pjesë e MKR, për bashkinë Korçë ka sjellë problematika në menaxhimin e rasteve ashtu siç duhet, përfshirë këtu koordinatoren vendore, pozicion ky 2 mbetur bosh për 7 muaj.
- Dhënia e shërbimit emergjent për viktimat e dhunës në familje pa organizat partnere do të ishte shumë i vështirë për menaxhim në territorin e kësaj bashkie. Nuk ka staf dhe buxhet për mbulimin e shërbimit psiko-social dhe ndihmës së drejtpërdrejtë për përfituesit. Ndaj rekomandohet adresimi dhe alokimi i fondeve nga bashkia Korçë për këtë problematikë.
- Të mbijetuarat e dhunës orientohen gjithmonë drejt punësimit me anë të ndërmjetësimin të Zyrës Rajonale të Punësimit, por në shumicën e rasteve ato nuk shkojnë për të punuar, ndaj është e nevojshme një ndërhyrje edhe më e thellë dhe e detajuar për integrimin e tyre.
- Në Korçë nuk ka mundësi për trajtim rehabilitues afatgjatë për viktimat e dhunës në familje. Ky është një tjetër rekomandim përse i përket menaxhimit në vazhdimësi pas kalimin të fazës së emergjencës.